



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PROGRAMI PER SUNDIMIN EFEKTIV TE LIGJIT

dhe

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT

2014 - 2019

Maj 2014

MOHIM PËRGJEGJËSIE

Kjo Rregullore është mundësuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e autorit në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdo qëndrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Për gjyqësorin është e rëndësishme që publiku të informohet saktë dhe me kohë rreth zhvillimeve të sistemit të drejtësisë.

Puna efektive me media është pjesë kyçe e punës së mëtejme të gjyqësorit në fushën e komunikimit për të njoftuar publikun rreth aktiviteteve të KGJK-së dhe gjykatave, politikave, proceseve dhe procedurave që janë me interes të veçantë, me qëllim të ngritjes së besimit të qytetarëve në efikasitetin në sistemin e drejtësisë.

Zyra Koordinuese për Komunikim e KGJK-së dhe Zyrtarët për Informim Publik të gjykatave janë urë lidhëse dhe burim i informatave për tërë sistemin gjyqësor në Kosovë. Për ZIP të gjyqësorit është me rëndësi të veçante të sigurojnë, grumbullojnë dhe shpërndajnë informata për qytetarët dhe mediat, në baza ditore, ose edhe në bazë të kërkesave dhe nevojave.

Përmes Strategjisë për Komunikim 2014-2019 synohet të fuqizohet bashkëpunimi në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatave të Republikës së Kosovës me median dhe publikun.

KGJK njeh të drejtën e qytetarëve për të pasur qasje në të dhënat publike në përputhje me legjislacionin në fuqi përkatësisht Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të drejtën e mediave për të raportuar mbi çështjet e interesit publik.

Sfida qëndron në zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit të Strategjisë së Komunikimit, gjë që kërkon angazhimin e KGJK-së dhe të të gjitha gjykatave. Më tutje, Strategjia për Komunikim 2014-2019 identifikon mjetet dhe metodat e komunikimit për përcjelljen e mesazheve drejt publikut për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Që nga 1 janari 2013 me hyrjen në fuqi të strukturës së re të gjykatave, u krijua dhe pozita e re e Zyrtarit për Informim Publik pranë gjykatave. Kjo solli nevojën për krijimin e një Strategjie për Komunikim që të rregullojë komunikimin mes KGJK dhe gjykatave me median dhe publikun.

DEKLARATA E MISIONIT

Misioni i gjyqësorit në fushën e komunikimit me publikun është të sigurojë informacion të afatshëm, të duhur dhe të plotë dhe të flasë me një zë unik duke ruajtur pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

DEKLARATA E VIZIONIT

Gjyqësori i Kosovës synon të fitojë besimin e publikut duke rritur vetëdijësimin e publikut për rolin që luan si Gjyqësor i pavarur, i paanshëm dhe transparent; duke siguruar drejtësi dhe qasje të barabartë dhe të lehtë në shërbimet e gjykatave për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

QËLLIMI I STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT

Qëllimi i kësaj strategjie është krijimi dhe zbatimi i udhëzimeve për publikimin e informatave të të gjitha gjykatave dhe KGJK-së që janë me rëndësi për publikun. Kjo Strategji mundëson që KGJK dhe gjykatat të veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike për të drejtat e njeriut dhe sigurisë publike të njohura ndërkombëtarisht.

Strategjia shërben për të mundësuar koordinimin e aktiviteteve për komunikim të rregullt dhe të vazhdueshëm mes KGJK-së dhe gjykatave me mediat, shoqërinë civile dhe qytetarët, si një ndër mënyrat më efikase të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Qëllimi 1: Udhëheqje strategjike dhe koordinim i informacionit

Gjyqësori paraqitet me një zë të unifikuar në plasimin e informacionit nga gjykatat e Kosovës. Strategjia e Komunikimit udhëzon KGJK dhe gjykatat që të koordinohen çdo herë kur përcjellin informacion tek mediat dhe komunikojnë me publikun e gjerë, në mënyrë që pozicioni dhe zëri i gjyqësorit të jetë i unifikuar.

Qëllimi 2: Ndërveprim gjyqësor-publik

Gjyqësori komunikon në mënyrë interaktive me publikun për të rritur qasjen e publikut në informata dhe për të fuqizuar besimin e publikut në gjyqësorin e Kosovës. Në përputhje me këtë qëllim, KGJK dhe gjykatat realizojnë aktivitete të ndryshme dhe krijojnë mundësi të shumta që publiku të ketë qasje të lehtë dhe të papenguar në informata mbi punën e KGJK dhe gjykatave.

Qëllimi 3: Marrëdhënie proaktive media-gjyqësor

Gjyqësori forcon marrëdhënie proaktive media-gjyqësor për të promovuar raportimin e saktë dhe të balancuar për KGJK dhe gjykatat. Në përputhje me këtë qëllim, KGJK dhe gjykatat përmes Zyrës Koordinuese për Komunikim dhe Zyrtarëve për Informim Publik ndërmerr hapa proaktive për ta sjellë informacionin mbi punën e gjyqësorit pranë mediave dhe publikut.

Qëllimi 4: Qasje e lehtë në informacionin publik

Gjyqësori shfrytëzon teknologji moderne të informacionit dhe teknika tradicionale të komunikimit për t'i siguruar publikut qasje të lehtë në informacionin për KGJK dhe gjykatat. Në përputhje me këtë qëllim, KGJK dhe gjykatat do të shfrytëzojnë uebfaqet e tyre si një kanal i fuqishëm i komunikimit dhe përcjelles së informatave. Gjithashtu, KGJK dhe gjykatat do të angazhohen në shfrytëzimin e platformave të medias sociale për të arritur tek audiencat e ndryshme, si një mënyrë për të rritur edhe më tej transparencën.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

1. Nxjerrja e rregulloreve të brendshme që rregullojnë punën dhe pozicionimin e zyrtarëve për informim publik brenda sistemit gjyqësor.
2. Funkcionalizimi i plotë i zyrtarëve për informim publik në të gjitha gjykatat.
3. Aftësimi i vazhdueshëm profesional i zyrtarëve për informim publik të KGJK-së dhe gjykatave.
4. Strukturimi i komunikimit të brendshëm në KGJK dhe gjykata (epror – zëdhënës/zyrtarë për informim).
5. Ofrimi i qasjes së shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun.
6. Koordinimi i aktiviteteve të KGJK-së dhe të gjykatave në fushën e marrëdhënieve me publikun në drejtim të procesit të integriteteve evropiane.
7. Përcjellja me kohë e të gjitha informatave relevante nga gjyqtarët tek zyrtarët për informim publik.
8. Rritja e komunikimit me qytetarët për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të gjyqësorit.

UDHËZUES STRATEGJIKË PËR KOMUNIKIMIN QELLIMI 1

Udhëheqje strategjike & koordinim i informacionit

Udhëzime strategjike

- Zyrtarët për Informim Publik janë punësuar
- Komunikimi i brendshëm gjyqësor është sistematizuar
- Implementimi i planit të komunikimit ka filluar
- Të funksionalizohet Ekipi Koordinues për Komunikim

QELLIMI 2

Ndërveprim publik-gjyqësor

Udhëzime strategjike

- Audiencia të ndryshme janë të informuara rreth shërbimeve gjyqësore
- Matet qasja në gjykata dhe opinioni publik
- Publiku merr pjesë në forume diskutimesh & organizime

QELLIMI 3

Marrëdhënie proaktive media-gjyqësor

Udhëzime strategjike

- Udhëzuesi për Media i shtjelluar në bashkëpunim me median
- Zyrtarët për informim publik të gjykatave janë trajnuar në marrëdhënie proaktive me media
- Janë kultivuar kontakte me media nacionale, rajonale dhe lokale
- Gazetarët janë njoftuar rreth strukturës së gjykatave & proceseve gjyqësore

QELLIMI 4

Qasje e lehtë në informacion publik

Udhëzime strategjike

- Shpërndahet informacion me kohë, i saktë dhe i dobishëm
- Uebfaqet e gjykatave janë funksionalizuar dhe freskohen rregullisht
- Të formulohen & implementohen procedura për media sociale
- Është hartuar plani për komunikim në raste krizash

MESAZHET KYÇE

AUDIENCA E SYNUAR

Publiku përgjithshëm*

- *Gjyqësori i Kosovës punon çdo ditë të fitojë besimin e publikut.*
- *Sistemi gjyqësor i Kosovës i shërben interesit të publikut; ai i përket të gjithë qytetarëve të Kosovës pavarësisht origjinës së tyre kombëtare, racës, fesë, kulturës, gjinisë, moshës, nevojave të vecanta, të ardhurave apo nivelit arsimor.*
- *Gjyqësori i pavarur mbron sundimin e ligjit duke ndarë drejtësinë në mënyrë të paanshme, efikase dhe të vazhdueshme.*

* Mesazhet do të përshtaten për të identifikuar nevojat dhe interesat e nën-grupeve të popullsisë në varësi të kanaleve të komunikimit që do të përdoren

**AUDIENCA E
SYNUAR**

Media

- *Media dhe Gjyqësori i shërbejnë interesit të informimit publik. Për të arritur këtë, gjykatat dhe media bashkëpunojnë duke respektuar rolet e tyre të ndara në një demokraci kushtetuese.*
- *Media është partner kryesor për të siguruar informacion të me kohë, të saktë dhe të plotë rreth sistemit të drejtësisë duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin gjyqësor.*
- *Gjyqësori i Kosovës është i përkushtuar të kultivojë marrëdhëniet proaktive dhe profesionale me median.*

AUDIENCA E SYNUAR

Shoqëria civile

- *Gjyqësori i Kosovës inkurajon komunikimin me shoqërinë civile.*
- *Gjyqësori i Kosovës ofron informacion të plotë për organizatat e shoqërisë civile që ato të kryejnë misionin e tyre në përputhje me interesin e publikut.*

Sektori i biznesit

- *Një Gjyqësor i pavarur që respekton me besnikëri sundimin e ligjit dhe nuk preket nga ndikimet politike apo presioni publik është simboli i një demokracie të qëndrueshme dhe kontribuon në stabilitet ekonomik.*
- *Një Gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm frymëzon besim në sigurinë dhe parashikueshmërinë e transaksioneve ekonomike.*

Organizatat partnere

Gjyqësori punon bashkë me organizatat partnere që kanë të njëjtat qëllime dhe mandat plotësues për të ruajtur dhe mbështetur pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Mënyrat/Mjetet e Komunikimit

Mënyrat/Mjetet e komunikimit	Sa shpesh
<ul style="list-style-type: none"> • Uebfaqe shumëgjuhëshe (interaktive) 	Freskohet çdo ditë
<ul style="list-style-type: none"> • Libër udhëzues për gjykata në shumë gjuhë (shtyp/online) 	Çdo vit
<ul style="list-style-type: none"> • Njoftime publike në shumë gjuhë (shtyp/elektronike) 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> • Pamflete/broshura/formularë edukativë në shumë gjuhë 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> • Organizime (audienca të synuara) 	Periodikisht
<ul style="list-style-type: none"> • Email (të gjitha audiencat) 	Çdo ditë
<ul style="list-style-type: none"> • Rrjete sociale (Facebook/Twitter/YouTube, Blogje) 	Çdo ditë
<ul style="list-style-type: none"> • Tryeza të rrumbullakëta media-gjyqësor 	Çdo një vit
<ul style="list-style-type: none"> • Formularë për komente nga publiku (audience të synuara) 	Periodikisht
<ul style="list-style-type: none"> • Telefonata (të gjithë audiencat) 	Çdo ditë
<ul style="list-style-type: none"> • Punëtori trajnimi (zyrtarë për informim publik/media) 	Periodikisht

Mënyrat/Mjetet e komunikimit	Sa shpesh
<ul style="list-style-type: none"> Takime me organizata partnere 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Seminare edukative (audience të synuara: gratë, nxënës, studentë, minoritetet, etj) 	Periodikisht
<ul style="list-style-type: none"> Forume me tema specifike (publiku i gjerë) 	Periodikisht
<ul style="list-style-type: none"> Tryeza të rrumbullakëta (sektori i biznesit – Gjykata Themelore Prishtine) 	Periodikisht
<ul style="list-style-type: none"> Hulumtime të opinionit publik (audienca të synuara) (nga Keshilli Gjyqesor i Kosoves) 	Çdo dy vjet
<ul style="list-style-type: none"> Njoftime për media (sipas nevojës) Përmbledhje (cdo jave) 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Komunikata për shtyp 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Intervista në media Konferenca për shtyp e rregullt (cdo gjashte muaj) 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Imazhe në media elektronike dhe lajme video 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Buletinë dhe E-Buletinë (audience të synuara) (vetem Keshilli Gjyqesor i Kosoves) 	Cdo tre muaj
<ul style="list-style-type: none"> Njoftime & Sinjalizime të shpejta (situata emergjencë) 	Sipas nevojës
<ul style="list-style-type: none"> Ligjërues të ftuar (shkollat) 	Periodikisht

MONITORIMI & RISHIKIMI

Gjyqësori i Kosovës do të shfrytëzojë një sërë mjeteve të hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ, duke përfshirë komente të drejtpërdrejta nga palët nëpër gjykata dhe publiku i përgjithshëm, monitorim të medias, hulumtime mbi perceptimin e publikut, analiza të uebfaqeve, për të përcjellë efektshmërinë e komunikimit. Për më tepër, KGJK do të caktojë / rekrutojë një zyrtar i cili është përgjegjës për monitorimin e realizimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Planit të Veprimit.

CAKTIMI I BURIMEVE

Gjyqësori i Kosovës do të caktojë sipas nevojës burimet e nevojshme njerëzore, financiare, teknike dhe institucionale për të zbatuar dhe për të arritur qëllimet e strategjisë së komunikimit.